



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 36

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i KM nr.1, datë 8.5.2003	Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K”	1241
Udhëzim i KM nr.2, datë 8.5.2003	Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit.....	1245
Vendim i GJK nr.13, datë 15.4.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.32, datë 1.6.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd; nr.235, datë 14.11.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.145, datë 21.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues	1250
Vendim i GJK nr.18, datë 14.5.2003	Me objekt interpretimin përfundimtar të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.....	1253
Rregullore e Bankës së Shqipërisë	Mbi procedurat e shitjes së mallrave me ankand në Bankën e Shqipërisë.....	1262

U D H Ë Z I M
Nr.1, datë 8.5.2003

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, TË VLERAVE NË TREGUN E LIRË TË BANESAVE DHE TË KOEFICIENTIT “K”

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

1. Kostoja e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave në shkallë republike, për vitin 2003, të jetë 29 253 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, për qytetin, për vitin 2003, të jetë sipas tabelës “Të dhëna për tregun e lirë të apartamenteve”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Vlera e koeficientit “K” të jetë sipas tabelës përkatëse, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Në tabelën nr.1 të udhëzimit nr.3, datë 16.10.2002 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K”, kostoja mesatare për njësi sipërfaqeje ndërtimi të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave për qytetin e Kavajës, për vitin 2002, nga 33 795 (tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë/m² bëhet 25 784 (njëzet e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) lekë/m².

5. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Kosto mesatare e ndërtimit

Tabela nr.1

Nr	Qyteti	Çmimi për njësi (mes.arit.)		% Invest. kundrejt totalit	Pjesë e çmimit sipas %	
		Sip.Shfryt.	Sip.Ndërt.		Sip.shfrytëz.	Sip.Ndërt.
		Lek/m ²	Lek/m ²		Lek/m ²	Lek/m ²
1	Berat	27 265	22 966	2.94	802	675
2	Dibër	32 390	25 352	2.06	667	522
3	Durrës	31 541	27 218	7.83	2 470	2 131
4	Elbasan	25 624	20 057	8.55	2 191	1 715
5	Fier	27 473	21 103	4.14	1 137	874
6	Gjirokastër	28 967	24 400	1.33	385	325
7	Gramsh	26 648	20 858	0.44	117	92
8	Kavajë	29 388	24 755	5.47	1 608	1 354
9	Korçë	29 692	24 379	4.56	1 354	1 112
10	Krujë	31 361	24 547	1.33	417	326

11	Kuçovë	27 407	21 452	1.15	315	247
12	Kukës	30 963	24 236	1.46	452	354
13	Laç	28 955	24 390	2.73	790	666
14	Lezhë	30 857	24 738	2.19	676	542
15	Librazhd	26 078	20 412	0.75	196	153
16	Lushnjë	28 080	23 652	2.49	699	589
17	Mirditë	26 822	22 593	0.73	196	165
18	Mat	30 836	24 136	2.89	891	698
19	Peqin	30 541	21 782	0.28	86	61
20	Përmet	27 835	23 447	0.88	245	206
21	Pogradec	30 568	25 749	1.26	385	324
22	Pukë	32 513	25 898	0.72	234	186
23	Sarandë	27 461	23 131	1.04	286	241
24	Shkodër	31 906	25 414	11.15	3 558	2 834
25	Skrapar	29 023	22 717	2.36	685	536
26	Tepelenë	29 726	23 267	2.29	681	533
27	Tropojë	32 500	25 438	1.21	393	308
28	Vlorë	34 732	27 504	5.35	1 858	1 471
29	Tiranë	26 848	22 615	20.41	5 480	4 616
Kosto mesatare		29 448	23 731		29 253	23 855

Të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve

Tabela nr.2

Nr	Qytetet	Kosto e shitjes lekë/m2 sip. shfrytëz.për tregun e lirë (3:5)
1	2	3
1	Berat	31447
2	Bulqizë	16762
3	Cërrik	24138
4	Çorovodë	12942
5	Delvinë	19043
6	Devoll	27973
7	Dibër	22828
8	Durrës	51724
9	Elbasan	45346
10	Fier	48294
11	Fushë-Arrëz	5850
12	Fushë-Krujë	29359
13	Gjirokastrë	34188
14	Gramsh	20892
15	Has	29878
16	Himarë	42861
17	Kavajë	45246
18	Këlcyrë	13765
19	Kolonjë	22918
20	Korçë	41496
21	Krujë	37561
22	Kuçovë	26472
23	Kukës	27505
24	Laç	27854
25	Leskovik	16470

26	Lezhë	43396
27	Librazhd	30843
28	Lushnjë	37115
29	M.Madhe	29091
30	Maliq	20692
31	Mallakastër	31805
32	Mamurras	20855
33	Mat	26447
34	Memaliaj	11689
35	Mirditë	26312
36	Patos	25514
37	Peqin	26356
38	Përmet	34045
39	Pogradec	42697
40	Poliçan	13783
41	Pukë	14332
42	Roskovec	25714
43	Rubik	23147
44	Sarandë	42861
45	Shëngjin	41509
46	Shkodër	45002
47	Tepelenë	26670
48	Tiranë	53450
49	Tropojë	20605
50	Vau-Dejë	23317
51	Vlorë	48845

VLERA e Koeficientit “K” sipas ligjit nr.8030 dATë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”

Tabela nr.3

Nr	Qytetet	Vlera e koeficientit “K”
1	2	(3:6)
1	Berat	1.000
2	Bulqizë	0.517
3	Cërrik	0.941
4	Çorovodë	0.445
5	Delvinë	0.693
6	Devoll	0.942
7	Dibër	0.704
8	Durrës	1.000
9	Elbasan	1.000
10	Fier	1.000
11	Fushë-Arrëz	0.179
12	Fushë-Krujë	0.936
13	Gjirokastrë	1.000
14	Gramsh	0.783
15	Has	0.964
16	Himarë	1.000
17	Kavajë	1.000
18	Këlcyrë	0.494
19	Kolonjë	0.771

20	Korçë	1.000
21	Krujë	1.000
22	Kuçovë	0.965
23	Kukës	0.888
24	Laç	0.961
25	Leskovik	0.554
26	Lezhë	1.000
27	Librazhd	1.000
28	Lushnjë	1.000
29	M.Madhe	0.911
30	Maliq	0.696
31	Mallakastër	1.000
32	Mamurras	0.720
33	Mat	0.857
34	Memaliaj	0.393
35	Mirditë	0.980
36	Patos	0.928
37	Peqin	0.857
38	Përmet	1.000
39	Pogradec	1.000
40	Poliçan	0.474
41	Pukë	0.440
42	Roskovec	0.935
43	Rubik	0.862
44	Sarandë	1.000
45	Shëngjin	1.000
46	Shkodër	1.000
47	Tepelenë	0.897
48	Tiranë	1.000
49	Tropojë	0.634
50	Vau-Dejës	0.730
51	Vlorë	1.000

U D H Ë Z I M
Nr.2, datë 8.5.2003

PËR KLASIFIKIMIN DHE STRUKTURËN E KOSTOS SË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

KREU I

I. KLASIFIKIMI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Me punime ndërtimi të veprave të ndryshme, që projektohen dhe zbatohen nga persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, do të kuptojmë:

- A. Punimet e ndërtimit
- B. Punimet teknologjike dhe të montimit
- A. PUNIME NDËRTIMI

Vlerësohen punime ndërtimi punimet e mëposhtme, të parashikuara në projektet ndërtimore (përfshirë edhe rikonstruksionet, zgjerimet e përshtatjet):

1. Ndërtesa banimi, arsimore, shëndetësore, social-kulturore, industriale etj., duke përfshirë instalimet e zakonshme:

a) instalimet e brendshme elektrike të citofonisë, telefonisë, televizive, përfshirë përcjellësit, tubacionet, çelësat, prizat e kutitë shpërndarëse, portollampat, automatët në apartamente ose në katet e ndryshme etj.;

b) instalimet e brendshme hidrosanitare për furnizimin me ujë dhe kanalizimet e ngrohjes, të ventilimit, kondicionimit, përfshirë aparatet sanitare, tubacionet e rakorderitë e çdo lloji, si dhe radiatorët, saraçineskat, valvolat etj.;

c) rrjetin e infrastrukturës, brenda e jashtë sheshit të ndërtimit, si: furnizimi me energji elektrike, telefoni, ujësjellës, kanalizime, sistemime, rrugë e sheshe, si dhe rrethimin e përhershëm.

2. Rrugët automobilistike, hekurudhore dhe të dekovilit, si dhe veprat përkatëse të artit, në kompleks dhe ato të veçanta, si: ura, tunele, mbikalimet ndërtim teleferikësh, me stacionet përkatëse etj.

3. Ujësjellësit, kanalizimet, tubacionet e jashtme të gazit e të karburantit, përfshi veprat e marrjes, stacionet e pompimit dhe të pastrimit, rezervuarët etj.

4. Linjat e jashtme ajrore dhe nëntokësore, elektrike, të telefonisë, radiofonisë, të televizionit, përfshirë përcjellësit, izolatorët, shtyllat dhe punimet e tjera të ndërtimit.

5. Hidrocentralet, termocentralet, nënstacionet, kabinat elektrike, përfshirë ndërtimet dhe rrjetin e infrastrukturës, brenda dhe jashtë sheshit të ndërtimit.

6. Punimet për kullim-ujtjen, përfshirë veprat e artit, në kompleks dhe ato të veçanta, si: diga, ujëmbledhës, urë-kanale, stacione pompimi etj.

7. Portet dhe aeroportet, përfshirë ndërtesat e ndryshme, rrjetin e infrastrukturës, brenda dhe jashtë sheshit të ndërtimit.

Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat.

B. PUNIME TEKNOLOGJIKE DHE TË MONTIMIT

Vlerësohen punime teknologjike dhe të montimit punimet e parashikuara në projektet teknologjike, që përbëhen nga:

- Punimet teknologjike

- Punimet e montimit.

PUNIMET TEKNOLOGJIKE

Në këto punime përfshihen:

1. Instalimet e tubacioneve teknologjike, të ngrohjes e ftohjes, të ajrit të ngjeshur e të kondicionuar, të furnizimit të gazit e lëndëve djegëse, përfshi pjesët speciale (si bërrylat, tridegëshet, zvogëluesit etj.), aparaturat e ndryshme të komanduara me dorë (si saraçineska, ventila, valvola, hidrante etj.), detajet e tubacioneve të ajrimit (si farfalat, pjesët speciale, thithëset etj.), konstruksionet mbështetëse e varëse të tubacioneve, si dhe provat pa ngarkesë të tyre dhe të linjave.

2. Instalimet elektrike të fuqisë dhe tensionit, matje-kontrollit e të drejtimit, orifikimit e sinjalizimit të mbrojtjes nga mbitensionet, rrufepritësit e të tokëzimit etj., përfshirë të gjitha llojet e kablllove, përcjellësve dhe tubacioneve, muftat e kokat e kablllove, konstruksionet mbështetëse e varëse, izolatorët mbështetës, kalues e varës dhe shinat elektrike, prizat dhe çelësat e ndryshëm të fuqisë motorike, me përjashtim të blloqeve të gatshme të shinave, paneleve të fuqisë motorike (përfshi matësit, shinat, izolatorët, çelësat e automatët etj. brenda tyre), si dhe të punimeve elektrike brenda kabinave etj.

Në këto punime përfshihen dhe provat pa ngarkesë të linjave.

3. Punimet ndërtimore të anës teknologjike, si ndërtimi i bazamentëve, bojatisja e konstruksioneve, rezervuarëve, tubacioneve, pajisjeve dhe makinerive etj., veshja me muraturë e materialeve të ndryshme izoluese ndaj temperaturës e gërryerjeve të tubacioneve, pajisjeve dhe makinerive, përfshi veshjen me rrjetë teli e llamarinë për mbrojtjen e izolimeve etj.

PUNIMET E MONTIMIT

Në këto punime përfshihen punimet për montimin e pajisjeve dhe të makinerive, si:

1. Montimi i makinerive metalpunuese, transportuese e ngritëse (ashensorë, elevatorë, transportierë, vinç-ura, monorelsa etj.), presa, pompa, kompresorë etj.

2. Montimi i kaldajave në ndërtesat qytetare dhe industriale, përfshirë barabanet, skeletet e

sheshet metalike, aksesorët si dhe aparatet e ndryshme (si manometër, termometër etj.).

3. Montimi i pajisjeve dhe aparaturave të ndryshme, me apo pa presion, të parashikuara në projektet teknologjike, të gatshme ose në pjesë, si: bunkerë, rezervuarët, ushqyesit, ciklonet, skeletet e sheshet metalike të tyre etj. (edhe në rastin kur përgatiten nga sipërmarrësi).

4. Aksesorët dhe mbushjet e pajisjeve teknologjike, si zgarat, portat e bokaportat dhe mekanizmat përkatëse në kaldajat e furrat, mbushjet me kimikate (si katalizatorë, rrëshirë, rashike, pjata e unaza porcelani dhe materiale të ndryshme) etj.

5. Montimi i pajisjeve dhe aparaturave në instalimet e ndryshme elektrike, telefonike, citofonike, si më poshtë vijon:

a) montimi i llampave të zakonshme dhe i ndriçuesve të çdo lloji (me përjashtim të portollampave të zakonshme), paneleve, kuadrove shpërndarëse të fuqisë motorike, komandimit, sinjalizimit, ndriçimit të kasetave elektro-telefonike e të matje-kontrollit, përfshirë pajisjet e montuara brenda tyre;

b) montimi i pajisjeve dhe i instalimeve në kabinat elektrike, centraleve telefonike, nënstacioneve e transformatorëve (përfshi vajin), gjeneratorëve, akumulatorëve, reaktorëve, elektromotorëve etj.;

c) montimi i aparateve dhe pajisjeve të fuqisë motorike, të matje-kontrollit, të drejtimit dhe sinjalizimit, si dhe i çelësave, siguresave, shkarkuesve e lëshuesve magnetikë etj.

6. Montimi i boljerëve, pompave, aspiratorëve, kondicionerëve, rezervuarëve, qendrorë e vendorë, matësve të ujit, gazit, energjisë, aparateve telefonikë etj. në ndërtesat e instalimet e çdo lloji, si dhe i armaturave të ndryshme, si saraçineska, valvola etj., të komanduara me energji elektrike ose pneumatike etj.

7. Montimi i pajisjeve elektroshtëpiake, perdeve, luksaflekseve, dollapëve, të tryezave për ndërtesat e ndryshme, qytetare dhe industriale etj. Në këto punime përfshihen edhe shkarkimi, depozitimi, dekonservimi i pajisjeve dhe makinerive, përfshirë transportin në vendin e montimit dhe provat pa ngarkesë të tyre.

KREU II

B. STRUKTURA E KOSTOS SË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Shpenzimet e punimeve të ndërtim-montimit përbëhen nga:

- shpenzime të drejtpërdrejta;
- shpenzime të përgjithshme;
- fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).

A. SHPENZIMET E DREJTPËRDREJTA

Janë shpenzimet që përcaktohen nëpërmjet llogaritjeve analitike në analizat e çmimeve njësores, për procese dhe zëra të ndryshëm punimesh ndërtim-montimi, ku përfshihen:

SHPENZIMET PËR PAGAT BAZË DHE SHITESËN MBI PAGË

Në pagat bazë përfshihen:

- shpenzimet për punën e kryer efektivisht ose kohën e nevojshme të punës së fuqisë punëtore, për kryerjen e zërave të punimeve të përfunduara, duke përfshirë gjithë nënproceset, si dhe shkarkimin e materialeve dhe të prodhimeve në objekt;

- pagat për vështirësitë teknike, si për punime në prani të ujit, nëntokë, në punën me turne (kur është parashikuar në projektorganizim) etj.;

- pagat për transportin e materialeve etj. nga vendi i depozitimit në objekt, për mbrojtjen e punimeve nga shiu, ngricat e dielli, si dhe pastrimi i vendit të punës.

Në shtesat mbi pagat, që sipas dispozitave përkatëse llogariten në përqindje mbi pagat bazë të fuqisë punëtore, përfshihen shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

SHPENZIMET PËR MATERIALET

Janë shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore e ndihmëse, të konstruksioneve e prodhimeve të ndryshme, të llogaritura për çdo zë pune, sipas kushteve teknike dhe të standardeve, me çmimet bazë, pa tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Çmimet e materialeve mund të jenë ose mbi mjetin e transportit të shitësi (përfshirë edhe ngarkimin) ose mbi mjetin e transportit të blerësi (përfshirë ngarkimin dhe transportin deri në objekt).

SHPENZIMET PËR TRANSPORTIN

Janë shpenzimet e transportit të materialeve, që blihen me çmim mbi mjetin e transportit të shitësi.

SHPENZIMET PËR MAKINERITË

Janë shpenzimet për makineritë që përdoren për punimet e ndërtim-montimit, për kohën e punës, vlerësuar me çmimet orare përkatëse, pa TVSH. Në rastin kur makineritë janë të sipërmarrësit, në çmimin orar të tyre parashikohen shpenzimet për:

- amortizimin (për investime dhe ndreqje të mëdha), për shërbime teknike dhe ndreqje të ndryshme (përfshi pagat, shtesat mbi pagë, materiale e pjesë këmbimi);
- karburant, lubrifikant e energji elektrike;
- pagat bazë dhe shtesat mbi pagë për manovratorët;
- transportin vajtje-ardhje dhe montim-çmontimin në objekt të makinerive, stacionare ose lëvizëse;

- amortizimin e gomave etj. për mjetet vetëlëvizëse;

- shpenzimet e përgjithshme dhe fitimin kur është veprimtari më vete.

Për makineritë e lehta, që punojnë në objekt, si vinça ndërtimi, saldatriçe etj., ku punëtoria parashikohet në kohën e punës së skuadrës së ndërtimit, çmimit orar i zbritet paga e manovratorit.

B. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI

Janë shpenzimet që nuk mund të llogariten e të vlerësohen me zëra pune, sepse ndryshojnë sipas llojit të ndërtimit, konstruksionit, rifiniturave, kohëzgjatjes së punimeve dhe strukturës organizative të sipërmarrësit etj., por llogariten me përqindje.

Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, që përfshihen në çmimet njësores të zërave të punës, për punimet e ndërtimit dhe punimet teknologjike llogariten me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta, ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit.

SHPENZIME TË PËRGJITHSHME

Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen:

1. Pagat bazë, shtesat mbi pagë e lejet e zakonshme të personelit inxhiniero-teknik e administrativ, rojeve, shoferëve etj. Këtu përfshihen pagat bazë dhe shtesat mbi pagë të fuqisë punëtore, që punon në objekt edhe për kohën e ndërprerjes së punës për arsye atmosferike etj.

2. Shpenzimet për amortizimin e mekanizmave, inventarit të imët dhe mjeteve vetjake (si trapano, krika, makara, karroca dore, vegla pune etj.).

3. Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidodë, ndihmë e shpejtë etj.

4. Shpenzimet e ndryshme për marketing, udhëtime e dieta, kancelari, ndriçim, telefoni, postë, autovetura, mjetet e furnizimit, të parkimit e magazinimit etj., si dhe interesat, siguracionet, taksat etj.

5. Shpenzimet periodike për punimet gjeotopografike gjatë ndërtimit, për provat e materialeve, prodhimeve e konstruksioneve, si dhe gjatë marrjes në dorëzim dhe kolaudit të punimeve etj.

6. Shpenzimet për marrjen me qira të ndërtesave të ndryshme dhe për ndërtime të përkohshme për zyra, magazina, nyje llaç-betoni e hekur-betoni etj., rrugët e vinç-kullave, ndriçimi i territorit, linjat e furnizimit me energji elektrike, telefoni, ujësjellës, kanalizime, si dhe sheshe e rrugë, brenda e jashtë sheshit të ndërtimit etj.

Për vepra të mëdha ose dhe ato të veçuara, në varësi të vendit të ndërtimit, kohëzgjatjes së punimeve etj., në marrëveshje dhe në mbështetje të projektorganizimit e preventivit përkatës mund të parashikohen më vete punimet për ndërtimet e përkohshme, që nuk përfshihen në shpenzimet e përgjithshme të sipërmarrësit, si ndërtimi i fjetoreve dhe magazinave të përkohshme, të fabrikës të betonit, asfaltbetonit, laboratorëve, bazave të prodhimeve dhe konstruksioneve etj.

7. Shpenzimet e paparashikuara në zërat e punës dhe në shpenzimet e drejtpërdrejta: zgjedhja e kampioneve, të rifiniturave, lagia, mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve nga shiu e ngricat pas kohës normale të punës, pastrimi dhe sistemimi i objektit e sheshit të ndërtimit, para dhe gjatë marrjes

në dorëzim etj.

FITIMI I SIPËRMARRËSIT

Fitimi për punimet e ndërtim-montimit, që ndryshon sipas llojit, madhësisë dhe kohëzgjatjes së objektit etj. llogaritet në përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta dhe plotësuese.

C. TË NDRYSHME

Në strukturën e investimeve dhe të ndërtimeve themelore, përveç punimeve të ndërtim-montimit përfshihen edhe:

- a) makineri e pajisje (teknologjike dhe të tjera),
- b) studime e projekte, duke filluar nga studimi i domosdoshmërisë dhe leverdisshmërisë së ndërtimit të veprës, deri në mbikëqyrjen e kolaudimin përfundimtar të saj.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË
TERRITORIT DHE I TURIZMIT
Besnik Dervishi

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANALIZA TEKNIKE

Shembull llogaritje nr.1

A-64/1Ndërtim mur tulle me llaç të veçantë
për 1m³

I - Punëtori:

a) Paga paga bazë (specialist + punëtor) orë 14.8 * 140 = 2072

b) Shtesë mbi pagë% 41.9 * 2072 = 868 Shuma Ilekë 2940

II - Materiale:

a) Tulla të zakonshme copë 400 * 12 = 4800

b) Llaç i zakonshëm m³ 0.25 * 4100 = 1025

c) Skelë inventarim 1.5 * 20 = 30 Shuma IIlekë 5855

III- Transport:

a) tulla nga 16 km ton.km 22,4 * 20 = 448

b) Llaç nga 7 km ton.km 3.5 * 22 = 77

Shuma IIIlekë 525

IV – Makineri:

Vinç 0.5 tonorë 0,55 * 180 = 99

Shuma IVlekë 99

V - Shpenzime të drejtpërdrejta shuma I-VI

Shuma Vlekë 9419

VI - Shpenzime të përgjithshme 8% dhe fitimi 10%

Shuma VIlekë 1695

Shuma V+VIlekë 11114

Çmimilek/m³ 11110

Shembull llogaritje nr.2

MONTIM POMPE

Me Q = _____ l/sek; H= _____ m. Për 1 copë

I - Punëtori:

a) Paga bazë (specialist+punëtor)orë 5 * 170 = 850

b) Shtesë mbi paga% 41,9 * 850 = 356

Shuma Ilekë 1206

II - Materiale:

a) Blerje pompe (vihet veç te fondi i pajisjeve)

b) Bërryla. Saraçineska hollandeze etj., sipas projektit me çmimet përkatëse

lekë= 794

Shuma IIIlekë 794

III - Transport:

Transporti i pompës përfshihet në çmimin e blerjes ndërsa bërrylat etj., sipas faktit

lekë 100

Shuma IIIlekë 100

IV – Makineri:

Vinçorë -----* 180 = ----

Shuma IVlekë ----

V- Shpenzimet e drejtpërdrejta shuma I-IV

Shuma Vlekë 2100

VI - Shpenzimet e përgjithshme 50% mbi pagat dhe fitimi

10% mbi shpenzimet e drejtpërdrejta e të përgjithshme

Shuma VIlekë 270

Shuma V+VIlekë 2370

Çmimilek/copë 2370

Shënim për të dy shembujt:

1) Përqindja e shtesave mbi pagat merret sipas dispozitave përkatëse ndërsa ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe fitimit sipas llogaritjes të sipërmarrësit

2) Në analizë çmimet janë orientuese pa TVSH, mbasi kjo parashikohet në fund të preventivit të zërave të punës.

V E N D I M

Nr.13, datë 15.4.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i““““

Gjergj Sauli Anëtar i““““

Alfred Karamuço Anëtar i““““

Kristofor Peçi Anëtar i““““

Kujtim Puto Anëtar i““““

Xhezair Zaganjori Anëtar i““““

Petrit Plloçi Anëtar i““““

Sokol Sadushi Anëtar i““““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 7.3.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.18 Akti që i përket:

KËRKUES: NEVIT KUKA e XHEVAHIR HILA, përfaqësuar nga avokate Arta

Danaj, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.32, datë 1.6.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd; nr.235, datë 14.11.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.145, datë 21.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit pretendojnë se të tre vendimet e gjykatave duhet të shfuqizohen si antikushtetuese për arsye se:

- Është shkelur parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Çështja është prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi rekursin e kërkuesit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd e ka dënuar të pandehurin Nevit Kuka për të njëjtën veprë penale, nga 13 vjet në 16 vjet burgim, duke shkelur nenin 425/3 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në rekurs, ndonëse janë ngritur probleme ligjore që kanë të bëjnë me kualifikimin ligjor të veprës penale, çështja nuk është shqyrtuar në seancë gjyqësore, por në dhomën e këshillimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushin, përfaqësuesen e kërkuesve, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd ka deklaruar fajtor Nevit Kukën dhe Xhevahir Hilën për veprën penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim dhe në bazë të neneve 140, 25 të Kodit Penal i ka dënuar respektivisht me 13 dhe 12 vjet burgim. Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Mbi bazën e rekursit të ushtruar nga të gjykuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.100, datë 10.3.1999, ka prishur dy vendimet dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd.

Me vendimin nr.32, datë 1.6.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd, ka dënuar Nevit Kukën dhe Xhevahir Hilën për veprat penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim parashikuar nga nenet 140 e 25 të Kodit Penal, me 16 dhe 12 vjet burgim.

Gjykata e apelit me vendimin nr.235, datë 14.11.2000 e ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.145, datë 21.2.2001, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjykata Kushtetuese çmon se në shqyrtimin e kësaj çështjeje, vlen të trajtohet më gjerë pretendimi i kërkuesit për rëndim të pozitës së të pandehurit. Pozita e të pandehurit nuk mund të rëndohet nga gjykata që shqyrton ankimin e tij. Ky është një rregull që në doktrinë dhe në jurisprudencë njihet si parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (reformatio in peius-lat). Mosrëndimi i pozitës së të pandehurit përmendet shprehimisht në legjislacionin tonë procedural penal dhe konkretisht në nenin 425 pika 3. Sipas këtij rregullimi ligjor, kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë ose t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar. Në Kodin e Procedurës Penale, ka edhe një dispozitë tjetër, konkretisht neni 244 pika 3 që nuk lejon gjykatën që të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori.

Megjithëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues. Gjykata Kushtetuese e konsideron zbatimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit si një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës më të lartë merr rëndësi në një shoqëri demokratike, prandaj askush nuk mund ta humbasë këtë përparësi. Ekzistenca e këtij parimi i jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre.

Parë nga ky këndvështrim, mosrespektimi i reformatio in peius do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të

nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut.

Për rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton shkelje të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Çështja është dërguar në Gjykatën e Lartë mbi rekursin e ushtruar nga të gjykuarit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar në vendimin e tij se gjykatat e të dy shkallëve kanë shkelur rëndë rregullat procedurale, sepse kanë pranuar që të pandehurit të mbrohen nga i njëjti avokat, ndërkohë që ndërmjet tyre ka pasur papajtueshmëri interesash. Ky kolegji arsyeton se në rigjykimin e çështjes në themel gjykatat duhet të respektojnë rregullat procedurale dhe të kryejnë një hetim gjyqësor të drejtë dhe të bazuar.

Neni 425 pika 3 i Kodit të Procedurës Penale, ka të bëjë me kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata e apelit dhe mosrëndimin e pozitës së të pandehurit e lidh me vendimin e apeluar. Kërkuksi pretendon se është rënduar pozita e tij nga gjykata e shkallës së parë, pasi çështja u prish dhe u kthye për rigjykim me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në këtë rast, pretendimi i tij nuk mund të bazohet në kërkesat e pikës 3 të nenit 425 të Kodit të Procedurës Penale, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit nuk e ka vendosur apeluesin në ndonjë pozitë më të rëndë në raport me vendimin e gjykatës së apelit. Kjo dispozitë kërkon njëkohësisht nga gjykata që shqyrton ankimin që të ketë parasysh vendimin e apeluar. Në rastin konkret, kur çështja ishte paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd për t'u shqyrtuar nga e para, e cila e dënoi të pandehurin Nevit Kuka me 16 vjet burgim, vendimi i apeluar nuk mund të merrej si referencë, sepse ishte i prishur.

Pretendimi i kërkuksit se gjykatat gjatë rigjyimit të çështjes kanë rënduar pozitën e të pandehurit duhet parë i lidhur ngushtë edhe me kërkesat e nenit 447 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e rigjyimit ka vetëm kufizimin që t'i përmbahet vendimit të Gjykatës së Lartë për çdo çështje të së drejtës që është vendosur në të. Kjo do të thotë se gjykata e rigjyimit për çdo çështje tjetër që nuk përmbahet në vendimin e Gjykatës së Lartë, është e lirë të vendosë vetë.

Nga shqyrtimi i rastit konkret nuk rezulton që gjykata e rigjyimit të mos u jetë përmbajtur çështjeve të së drejtës që arsyetohen në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Ajo ka evituar shkeljen procedurale lidhur me mbrojtësin, si dhe ka kryer një hetim në themel të çështjes, duke vlerësuar të gjitha rrethanat e kryerjes së veprës penale, pozitën e të pandehurve në të, kualifikimin ligjor të veprës së kryer, mbi bazën e të cilave ka vendosur dhe një masë dënimi. Nisur nga këto argumente, Gjykata Kushtetuese krijon bindjen se pretendimi për rëndim të pozitës së të pandehurit nuk është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër, sipas të cilit dhoma e këshillimit padrejtësisht nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, Gjykata Kushtetuese çmon se nuk duhet pranuar. Pikësëpari, kërkuksi kishte detyrimin të parashtronte në kërkesën e tij dhe në seancë gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese ato argumente që lidhen me shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Dhomës së Këshillimit. Megjithatë, nga aq sa ka pretenduar ai për antikushtetushmërinë e vendimit të Dhomës së Këshillimit, Gjykata Kushtetuese është e mendimit se nuk është detyrë e saj të vlerësojë në rekursin e paraqitur ekzistencën e atyre shkaqeve që në fakt kanë të bëjnë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe jo me shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky është një problem që u përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të konfundohet me qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese, kur ajo ka konstatuar në vendimet e Dhomës së Këshillimit moszbatim ose shkelje të parimeve esenciale që lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Aq më tepër që në rastin konkret kërkuksi, pretendimin për rëndim të pozitës së të pandehurit nuk është ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por vetëm në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Mbi bazën e arsytimit të sipërpërmendur, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa nuk përmban argumente që të vërtetojnë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor e për rrjedhojë ajo nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenin 131 shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr.18, datë 14.5.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci Anëtar i ““
Gjergj Sauli Anëtar i ““
Alfred Karamuço Anëtar i ““
Kristofor Peçi Anëtar i ““
Kujtim Puto Anëtar i ““
Xhezair Zaganjori Anëtar i ““
Petril Plloçi Anëtar i ““
Sokol Sadushi Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalicë, në datën 18.3.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.19 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP PREJ 32 DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga deputeti Spartak Braho.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.
2. GRUPI PARLAMENTAR “ALEANCA PËR DEMOKRACI”, në mungesë.
3. GRUPI PARLAMENTAR “LIBERAL DEMOKRAT”, në mungesë.
4. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË “BALLI KOMBËTAR”, në mungesë.
5. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË “LËVIZJA E LEGALITETIT”, në mungesë.
6. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË REPUBLIKANE, në mungesë.
7. GRUPI PARLAMENTAR I TË GJELBËRVE, në mungesë.
8. GRUPI PARLAMENTAR I QENDRËS LIBERALDEMOKRATE, në mungesë.
9. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATE, në mungesë.
10. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE, në mungesë.
11. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALDEMOKRATE, në mungesë.
12. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE, në mungesë.

OBJEKTI: Interpretimi përfundimtar i nenit 77 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

Grupi prej 32 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë ka ushtruar, përpara kësaj Gjykate, nismën për një gjykim kushtetues me objekt interpretimin përfundimtar të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Në kërkesë, ata, kanë parashtruar mendimin e tyre lidhur me kuptimin që i duhet dhënë frazës se Kuvendi “...është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë”. Interpretimin e kësaj fraze, grupi i deputetëve të Kuvendit, e ka kryer duke evidentuar këto momente kryesore:

Së pari, çështje e veçantë është çdo çështje jo e zakonshme, është një çështje, fenomen apo ngjarje e rëndësishme me impakt dhe interes të gjerë publik, shoqëror e kombëtar dhe që ndikon gjerësisht në zhvillime të caktuara të vendit;

Së dyti, ligji “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore parlamentare” i ndalon këto komisione të ngrenë akuza me karakter penal si dhe të ushtrojnë atributet e gjykatave;

Së treti, nuk mund të ngrihet komision hetimor ndaj personave pa imunitet dhe Kuvendi nuk mund të investohet në çështje që kanë të bëjnë me emra personash, përderisa ka organe të tjera që merren me këto çështje;

Së katërti, duhet të mbahet parasysh statusi i organeve të pavarura e kushtetuese, të cilat merren me kontrollat dhe hetimet, duke shmangur dualizmin e kompetencave të këtyre institucioneve nga njëra anë dhe Kuvendit nga ana tjetër.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushin, përfaqësuesin e kërkuarit, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, grupi prej 32 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët në kuptim të nenit 134 pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës përbëjnë jo më pak se një të pestën e deputetëve, kanë kërkuar që në nenin 77 pika 2 të Kushtetutës, të kryhet interpretimi përfundimtar i frazës “... është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.”.

Kërkuari i referohet paraprakisht në kërkesë dy qëndrimeve të ndryshme të mbajtura nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe interpretimit jo të njëlojtë që i është bërë kësaj dispozite të Kushtetutës, duke shprehur njëkohësisht dhe rezervat dhe kundërshtitë e tij për mënyrën e interpretimit.

Interpretimin e pikës 2 të nenit 77 të Kushtetutës dhe konkretisht të shprehjes “çështje e veçantë”, kërkuari e bën në funksion të vendimeve nr.69, datë 24.2.2003 dhe nr.70, datë 10.3.2003 të Kuvendit të Shqipërisë. Në vendimin e parë, Kuvendi nuk e miratoi ngritjen e komisionit parlamentar për hetimin e veprimtarisë së Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe ish-Ministrit të Kulturës, ndërsa në vendimin e dytë u miratua krijimi i komisionit hetimor parlamentar për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve publike dhe të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës dhe në Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002 dhe zbatimin e ligjshmërisë në zhvillimin urbanistik për qytetin e Tiranës për periudhën 1992-2002.

Ndodhur përpara një rasti të tillë, kur kërkuari evidenton se janë vërejtur qëndrime të ndryshme nga Kuvendi i Shqipërisë në lidhje me kuptimin që i është dhënë nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, dhe me qëllim, evitimin në të ardhmen të interpretimeve kontradiktore në praktikën parlamentare, Gjykata Kushtetuese çmon se paraqitja e kësaj kërkesë e investon atë të ushtrojë juridiksionin e saj kushtetues për të realizuar interpretimin përfundimtar.

Pavarësisht se objekti i kërkesës është interpretimi i nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të cilën kërkuari gjatë argumentimit e ka përqëndruar në interpretimin e frazës, Kuvendi “... është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë”, Gjykata Kushtetuese thekson se në rastin e dhënë, në kuptim edhe të nenit 124 të Kushtetutës, interpretimi nuk do të ishte i plotë, pa u analizuar pika 2 e nenit 77, në lidhje edhe me dispozita të tjera të Kushtetutës.

1. Sipas nenit 77 pika 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme si dhe cakton komisione të posaçme. Ai gjithashtu ka të drejtë dhe, me kërkesë të një të katërtës së deputetëve, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.

Pushtetit legjislativ, që mishërohet në veprimtarinë e Kuvendit, i përkasin funksionet kryesore të orientimit politik, të miratimit të ligjeve dhe të mbikëqyrjes së zbatimit të tyre. Ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshëm që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik e shtetasit si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve. Funksioni i rëndësishëm i ligjvënësit në shoqëritë demokratike materializohet pikërisht në rolin e përfaqësuesve të tij, që nga njëra anë miratojnë ligjet dhe nga ana tjetër, ushtrojnë kontrollin mbi pushtetet e tjera deri në atë masë që ky pushtet zbatohet.

Në këtë drejtim merr përparësi funksioni i kontrollit parlamentar, i cili nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë si dhe nxjerrjen e përgjegjësi, sipas rasteve konkrete.

Kontrolli parlamentar realizohet nëpërmjet një administrate që jep llogari, raporton dhe përgjigjet për veprimtarinë e saj. Nëpërmjet këtij kontrolli, parlamentarët kanë të drejtën të informohen për çështjet e administrimit të pushtetit dhe të zbatimit të ligjeve ose për çështje të caktuara, marrja dijeni mbi të cilat konsiderohet si e nevojshme për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të tyre, por gjithmonë brenda kuadrit të funksionit kushtetues.

Në një shoqëri demokratike, kjo mundësi që u jepet parlamentarëve, rrjedh nga e drejta e popullit për të njohur dhe ditur se çfarë bëhet në emrin e tij. Prandaj, kontrolli parlamentar ushtrohet edhe në kontekstin e të drejtës kushtetuese të çdo shtetasi për të marrë informacionin e nevojshëm në lidhje me çështjet me interes publik. Organet e pushtetit publik që i nënshtrohen kontrollit parlamentar, duke i transmetuar fakte e të dhëna përfaqësuesve të popullit, përbushin njëkohësisht detyrimin kushtetues për të qenë transparentë në raport me publikun.

Në këtë kontekst, Kuvendi, i cili u kërkon organeve të pushtetit të raportojnë rregullisht, ka edhe të drejtën që të hetojë mbi çështje të caktuara me interes publik që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim, në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar. Ato janë instrument i rëndësishëm i parlamentit për kryerjen e kontrollit kryesisht mbi ekzekutivin, si dhe për mbledhjen e informacionit për çështje të veçanta, me qëllim arritjen në përfundime të caktuara.

2. E drejta e Parlamentit për të ngritur komisione hetimore është një prerogativë dhe një mjet i domosdoshëm që i nevojitet për të ushtruar dhe perfeksionuar pushtetin e tij legjislativ. Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është për të njohur dhe verifikuar në thellësi një fenomen, një ngjarje, një veprimtari, me synimin që në përputhje me realitetin, të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit ose korrigjimit të ligjeve të veçanta.

Nga ana tjetër, nëpërmjet hetimit parlamentar, kontrollohet edhe zbatimi i ligjeve, nxirret përgjegjësi mbi mënyrën e qeverisjes dhe bëhen rekomandimet përkatëse me qëllim parandalimin dhe eliminimin e fenomeneve negative, si dhe përmirësimin e gjendjes në të ardhmen.

Kushtetuta është mjaftuar vetëm me sanksionimin e një dispozite me karakter të përgjithshëm, duke ia lënë ligjit përcaktimin e modaliteteve me dispozita më të hollësishme. Neni 77 pika 2, parashikon ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare me dy mënyra të ndryshme, në vartësi të subjekteve që ushtrojnë këtë të drejtë. Këto dy mënyra krijimi rezultojnë nga përdorimi në këtë dispozitë i shprehjeve “ka të drejtë” dhe “është i detyruar”.

Sipas këtij formulimi kushtetues, Kuvendi vihet në dy pozicione të ndryshme. Në njërin rast, krijimi i komisionit hetimor paraqitet si një e drejtë e Kuvendit, gjë e cila realizohet sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë ose në Rregulloren e Brendshme të Kuvendit dhe që i nënshtrohet vendimmarrjes përkatëse.

Nga ana tjetër, dispozita kushtetuese, duke parashikuar shprehjen “është i detyruar” merr një tjetër kuptim dhe nuk interpretohet në të njëjtën mënyrë me rastin e mësipërm.

Përdorimi në Kushtetutë i shprehjes “është i detyruar”, jo vetëm që e vendos Kuvendin në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por njëkohësisht, institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare.

E drejta për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor është parashikuar në Kushtetutë si e drejtë e një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit. Ngritja e komisionit me votë të një minorance ose siç pranohet në doktrinën kushtetuese, nëpërmjet zbatimit të parimit të hetimit me votim pakice, dëshmon në këtë drejtim një avancim demokratik të Kushtetutës sonë. Ekzistenca e këtij parimi, që përbën një veçanti të Kushtetutës, e forcon në mënyrë të konsiderueshme rolin e komisionit hetimor si një instrument efikas kontrolli.

E drejta e hetimit parlamentar është zhvilluar në kuptimin e së drejtës të pakicave në parlament, pavarësisht nga pozicionimi i tyre politik me qëllim, që t'u japë atyre një pushtet më të fortë. Së bashku me mjetet e tjera si pyetjet, interpelancat ose mocionet për debat, ngritja e komisioneve të hetimit përbën një instrument të rëndësishëm kontrolli që ushtrohet nga parlamenti. E drejta e hetimit realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese

që parlamentarët kryejnë si përfaqësues të popullit për sqarim ose hulumtim të hollësishëm në çështjen konkrete.

Kjo e drejtë shërben njëkohësisht edhe si një mjet në duart e pakicës parlamentare për të ushtruar kontroll kryesisht kundrejt ekzekutivit dhe për të kërkuar vënien përpara përgjegjësisë të mbajtësve të pushtetit. Në një sistem parlamentar, duke qenë se qeveria formohet nga shumica parlamentare, e cila ka në dorë shumë mjete të tjera ligjore, e drejta e kontrollit hetimor i është njohur sidomos pakicës, që duke i patur të kufizuara mjetet e saj, ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.

Kushtetuta, në nenin 77 pika 2 duke njohur të drejtën për të ngritur komisione hetimore, si e drejtë e një të katërtës së deputetëve për të vepruar në mënyrë të pavarur nga shumica parlamentare, ka evituar njëkohësisht edhe disa pengesa ligjore që mund të krijohen si rrjedhojë e vendimmarrjes. Nëpërmjet shprehjes “është i detyruar”, ajo ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet shumicës për të vendosur dhe të drejtës së pakicës së cilësuar.

Nga ky këndvështrim i problemit, Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta e pakicës vetëm përsa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor mbetet një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës. Njëkohësisht, e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të rasteve, kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohen se preken parimet kushtetuese.

3. Gjykata Kushtetuese është e mendimit se interpretimi i nenit 77 pika 2 të Kushtetutës duhet shoqëruar edhe me një analizë e vlerësim mbi disa çështje kushtetuese dhe norma ndërkombëtare të gjithëpranura, të cilat duhen respektuar nga Kuvendi në ngritjen e komisioneve hetimore.

E drejta e një të katërtës së deputetëve për të ushtruar hetimin parlamentar nuk mund të konsiderohet absolutisht e pakufizuar. I vetmi kufizim i saj është i lidhur me detyrimin që objekti i hetimit të jetë në përputhje me respektimin e parimeve të sanksionuara nga Kushtetuta. Ekzistenca e një kufizimi të tillë, edhe pse nuk përmendet në nenin 77 të Kushtetutës, është e kuptueshme dhe buron nga dispozita të tjera të saj.

E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Ky është formulimi i nenit 4 pika 1 të Kushtetutës, dhe nga detyrimi për të zbatuar këtë parim nuk mund të përjashtohet askush. Mbi bazën e këtij parimi kushtetues, Kuvendi ka miratuar ligjin nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore” dhe në nenin 4 ka parashikuar pikërisht ngritjen dhe funksionimin e tyre konform parimeve kushtetuese.

Sipas nenit 7 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Në demokracitë perëndimore parimi i ndarjes së pushteteve, megjithëse efektiv, nuk është zbatuar në mënyrë strikte duke mos ndjekur modelin ideal klasik.

Baza e përgjegjësisë parlamentare është raporti që krijohet në marrëdhëniet ndërmjet parlamentit dhe qeverisë. Parlamenti jo vetëm kontrollon qeverinë, por në çdo kohë, miraton dhe raporte ose rezoluta të veçanta instruktive për të. Në këtë mënyrë, duke ia besuar parlamentit funksionin kontrollues, sigurohet edhe balanca ndërmjet pushteteve, ç’ka përbën një arritje esenciale për një sistem institucional që funksionon mbi ndarjen dhe balancimin ndërmjet trupës legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore.¹ Në këtë drejtim, parimi i ndarjes së pushteteve nuk perceptohet në mënyrë dogmatike dhe formale, por në përputhje me objektivin për të penguar centralizimin e pushtetit në një institucion apo zyrtar.²

Nga ky vështrim doktrinar që jep jurisprudenca kushtetuese europiane, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se kontrolli parlamentar duhet zhvilluar në mënyrë të atillë, që të mos ndërhyjë pa kufizim në veprimtarinë e pushteteve të tjera. Një hetim i inicuar që nuk lidhet me qëllimet dhe që nuk i përket veprimtarisë së legjislativit, nuk konsiderohet në përputhje me parimet kushtetuese.

¹ Shih për këtë argument, D.P.Kommers, The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany 164 (1997), i cili i referohet artikullit të ish-gjyqtarit Konrad Hesse në *Grundzüge des Verfassungsrechts der Bundesrepublik Deutschland*, 16 th ed. 184-186.

² Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Letonisë, No. 03-04 (99).

Ky instrument i rëndësishëm nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit. Prandaj, ushtrimi i këtij mjeti juridik kushtetues për ato çështje dhe në ato pushtete, ndërkohë që parlamenti në aspektin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve mund ta ketë të pamundur ushtrimin e kontrollit, do të dëmtonte këtë kompetencë kushtetuese.

Një kompetencë e tillë nuk pengon, veçanërisht, pushtetin ekzekutiv në kryerjen e detyrave të administrimit publik. Çështjet e përditshme që trajtohen nga qeveria nuk janë objekt hetimi, pasi në aspektin e kontrollit parlamentar njihen edhe mjete të tjera të përshtatshme kushtetuese, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron kompetencat e tij mbi ekzekutivin. Ekzistojnë forma të ndryshme ndërveprimi dhe bashkëpunimi në marrëdhëniet ndërmjet pushtetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv, sikundër, është e pranueshme që ekzistojnë fusha ku kompetencat e autoriteteve të ndryshme mund të ndërthurren ose përputhen. Në këtë kuptim, objekt hetimi janë vetëm çështjet që përfshihen në veprimtarinë kontrolluese të parlamentit, të cilat nuk sjellin konfondime dhe transferime kompetencash të parashikuara nga Kushtetuta.

Parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton një mënyrë të veçantë për përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet autoritetit të gjykatave dhe pushteteve të tjera. Zakonisht, vetëm pavarësia e gjyqtarëve mbrohet në mënyrë strikte. Prandaj, marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe pushteteve të tjerë bazohen dhe orientohen kryesisht për nga parimi i ndarjes së tyre.

Një element esencial i ndarjes së pushteteve është pavarësia e gjykatave dhe gjyqtarëve. Ekzistenca e parimeve të tilla nuk pranon mbi veprimtarinë e gjykatave ndikime diktuese që mund të vijnë nga pushtetet e tjera. Vendimet gjyqësore mund të ndryshojnë nga një autoritet gjyqësor më i lartë dhe të vetmet përjashtime të pranueshme nga doktrina e së drejtës janë prerrogativa presidenciale e faljes dhe e drejta e ligjëvënësit për nxjerrjen e akteve të amnistisë.¹

Komisioni hetimor, duke hetuar një fushë të caktuar brenda kompetencave që përfshihen në përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit, mund të arrijë të gjejë të dhëna, të cilat përbëjnë shkak për t'u vlerësuar nga ana e tij, por pa hyrë në sferën e organeve hetimore e gjyqësore të ngarkuara nga Kushtetuta për veprimtari të këtij lloji. Raporti përfundimtar që harton komisioni sigurisht që nuk ka efekte detyruese mbi gjykatat, por ndikimi i tij në nivelin politik mund të jetë i konsiderueshëm.

Këto parime përjashtojnë çdo formë kontrolli parlamentar mbi aktivitetin juridiksional të gjykatave. Pavarësia e gjykatave nuk vendos embargo ndaj vlerësimeve kritike që mund të vijnë nga qytetarët ose deputetët, por artikullimi i këtyre vlerësimeve nëpërmjet raporteve të komisioneve hetimore parlamentare nuk është në përputhje me parimet kushtetuese.

Sigurisht, që të gjitha parimet kushtetuese janë të rëndësishme për t'u patur parasysh dhe për t'u respektuar gjatë ngritjes dhe ushtrimit të veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, por Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të evidentojë se një ndër parimet kushtetuese thelbësore, që merr rëndësi esenciale dhe që lidhet me garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor është parimi i prezumimit të pafajësisë. Ky parim është pranuar se mund të cenohet jo vetëm nga gjyqtarë apo gjykata, por edhe nga autoritetet publike.² Interpretimi i zgjeruar edhe tej procesit penal ofruar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut merr një rëndësi të veçantë edhe për sa i përket garantimit të të drejtave të parashikuara në Konventë në mënyrë praktike dhe efektive, jashtë kontekstit teorik ose iluziv.³ Ky parim mishërohet edhe në lidhje me zbatimin e nenit 6, paragrafi 2 të Konventës Europiane.

Gjatë aktivitetit hetimor, komisionet parlamentare ushtrojnë edhe kompetenca gjyqësore ose quasi gjyqësore. Ato janë të pajisura nga ligji me pushtete të njëjta me ato të organeve të hetimit e të gjykimit. Në këtë kuptim, komisionet hetimore duhet të garantojnë plotësisht këtë parim, duke mos e trajtuar a priori të interesuarin për çështjen në fjalë si fajtor.

Duke iu referuar të drejtës për informim të publikut, si një nga parimet themelore mbi të cilat

¹ Vendimi i Tribunalit Kushtetues Polak, K.6/94, pjesa II, 91.

² Shih *Allenet de Ribemont kundër Francës*, Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut i 10 shkurtit 1995, Ap. No. 15175/89, paragrafi 36.

³ Shih për këtë, *Artico kundër Italisë*, Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut i 13 majit 1980, A-37, paragrafi 33; *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut i 7 korrikut 1989, A-161, paragrafi 87; *Cruz Varas dhe të tjerët kundër Suedisë*, Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut i 20 marsit 1991, A-201, paragrafi 99.

ndërtohen e funksionojnë shoqëritë demokratike, Gjykata Kushtetuese çmon se në të tilla raste, komisionet hetimore parlamentare duhet të tregojnë kujdes në gjetjen e një balance mes të drejtës për informim dhe parimit të prezumimit të pafajësisë. Prandaj, respektimi i parimit të paanshmërisë në veprimtarinë e komisioneve hetimore është pjesë përbërëse e kuptimit të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Europiane¹ si dhe e konceptit kushtetues që lidhet me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës.

Pjesë e rëndësishme e respektimit të këtij parimi kushtetues është dhe kufizimi i lejueshëm që pranohet për zhvillimin e seancave jo publike. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se mundësia e publikut për të ndjekur seanca mund të kufizohet në disa rrethana të përcaktuara. Arsytet, për të cilat media dhe publiku mund të përjashtohen nga të gjitha seancat ose pjesë të tyre, janë morali, rendi publik, sigurimi kombëtar; kur e kërkojnë interesat ose jeta private e palëve, ose në ato raste, kur sipas mendimit të komisionit hetimor ose për rrethana të posaçme publiciteti, dëmtohen interesat e hetimit.

Në këtë drejtim, mbetet detyrë e Kuvendit dhe e komisioneve hetimore që të respektojnë të gjitha mbrojtjet kushtetuese që gëzon individ. Ligjvënësi nuk ka asnjë pushtet qoftë vetë, qoftë nëpërmjet ndonjë komisioni, të hetojë në çështjet private të shtetasve, për dëmtimin e qëllimshëm të këtyre personave, ose për çdo qëllim tjetër të panjohur ose spekulativ, me përjashtim të rasteve kur duhet të përmbushë qëllime të autorizuar e të ligjshme. Pretendimet që mund të ngrihen se kërkesa të caktuara të legjislativit ose të komisioneve hetimore përbëjnë dhunim të të drejtave kushtetuese të individit vendosen, rast pas rasti, nga gjykata kompetente që shqyrton çështjen konkrete.

Në këtë aspekt, ngritja e komisioneve hetimore për çështje që lidhen qoftë edhe me individin nuk përbën ndonjë pengesë kushtetuese. Megjithatë, hetimi duhet të priret nga mosndërhyrja në jetën private të individit, ose në gëzimin e lirë të të drejtave të tij kushtetuese, duke ekzistuar domosdoshmërisht një lidhje substanciale midis informacionit ose hetimit që kërkohet të realizohet dhe një shkallë të arsyeshme të qëllimit legjitim të legjislativit.

Nga një analizë e gjithanshme dhe interpretuese e dispozitës konkrete në raport edhe me norma të tjera, Gjykata Kushtetuese konkludon se respektimi i parimeve kushtetuese në procedurën për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare nuk cenon të drejtën e pakicës për realizimin e kësaj kompetence kushtetuese.

Kuvendi, në rastet kur kërkohet ngritja e komisionit hetimor nga një e katërta e deputetëve, ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit, por ia nënshton diskutimit parlamentar shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese në objektin e veprimtarisë së tij. Ky debat realizohet me qëllim gjetjen e një konsensusi ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit, deri në arritjen e një vendimmarrjeje.

Prandaj, kufizimet e lejueshme kushtetuese që kanë të bëjnë me respektimin e parimeve të rëndësishme fokusohen në objektin e hetimit, i cili nuk mund të reduktohet nga Kuvendi deri në atë masë sa t'ia bëjë të pamundur komisionit kryerjen e veprimtarisë. Kufizimi që mund t'i bëhet objektit të hetimit me argumentin se nuk respektohen parimet kushtetuese, nuk e bëjnë një vendimmarrje të tillë përfundimtare dhe të pakontrollueshme nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, për arsye se do ta vendoste të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare në vlerësimin e shumicës, duke dhunuar në këtë mënyrë ushtrimin normal të kësaj të drejte.

4. Nisur nga objekti i kërkesës së 32 deputetëve të Kuvendit për interpretimin përfundimtar të shprehjes çështje e veçantë, Gjykata Kushtetuese konkludon se natyrisht ajo mbetet pjesë e interpretimit në funksion të të gjithë nenit kushtetues. Megjithatë listimi i të gjitha rasteve se kush përfshihet në shprehjen kushtetuese çështje e veçantë nuk mund të jetë detyrë e saj, ose objekt i këtij vendimi interpretues. Nëpërmjet interpretimit, Gjykata ka parasysh të mos zhvendoset në pozicionin e një ligjvënësi pozitiv që krijon norma të reja kushtetuese, por të japë kuptimin e vërtetë që përmban vetë dispozita, në analizë edhe të normave të tjera të Kushtetutës. Prandaj, marrja përsipër e një detyre të tillë mund ta nxjerrë Gjykatën Kushtetuese jashtë funksionit të interpretimit të dispozitave kushtetuese.

Kushtetuta e Republikës e Shqipërisë paraqitet disi më ndryshe nga kushtetutat e vendeve europiane në formulimin që i bën motivit të ngritjes së komisioneve hetimore duke parashikuar se “Kuvendi...është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë”.

¹ Shih për këtë, *Demicoli kundër Maltës*, Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut i 27 gushtit 1991, A-210, paragrafët 30-42.

Nga një vështrim krahasues me disa kushtetuta të tjera rezulton se ngritja e komisioneve hetimore bëhet “për çështje me interes ose rëndësi të përgjithshme”, ose “për çështje me interes publik”. Nëse i referohemi praktikës ndërkombëtare, natyra e çështjeve të hetuara nga komisionet hetimore ka qenë e një rëndësie substanciale ose parësore për publikun, me ndikim të veçantë në marrëdhëniet ndërshtetërore, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësiwe institucionale dhe mospërsëritjen e fenomeneve të hetuara në të ardhmen. Në këtë drejtim, çështjet më të shumta kanë patur për objekt administrimin e fondeve publike, marrëdhëniet ndërshtetërore, falimentimet e korporatave ose subjekteve të ndryshme private, të cilët kanë patur impakt në ekonominë e vendit, ose hetimin e fenomeneve kriminale.

Në disa dispozita të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë janë përdorur formulime të tilla që përafrojnë me shprehjen “çështje e veçantë”. Konkretisht në nenet 80 pika 3, 123 pika 1, 134 pika 2 dhe 150 pika 1 e 2 gjenden shprehjet “çështje të ndryshme”, “çështje të caktuara” “çështje që lidhen me interesat e tyre”, “çështje të një rëndësie të veçantë”, etj. Sigurisht që kuptimi i tyre nuk është i njëjtë dhe as duhet konfunduar me shprehjen objekt interpretimi, por megjithatë, specifika që ato paraqesin i bënë të interpretueshme rast pas rasti.

E analizuar në aspektin gjuhësor, interpretimi i fjalës çështje merr kuptimin e një dukurie, gjendjeje, ngjarjeje apo fakti që ka nevojë të shqyrtohet për t’u zgjidhur. Ajo që e bën çështjen specifike, të rëndësishme, të posaçme, të jashtëzakonshme, që ndryshon nga të tjerët dhe që është karakteristike për një qenie, dukuri, ngjarje apo fakt është mbiemri “e veçantë”. Megjithatë, një kuptim më të plotë do të merrte shprehja “çështje e veçantë” nëse do të vlerësohej edhe në aspektin kushtetues.

Interpretimin e shprehjes çështje e veçantë, Gjykata Kushtetuese e realizon brenda konceptit të funksionit të kontrollit parlamentar dhe të së drejtës së pakicës për të përdorur këtë instrument të rëndësishëm sipas parimeve kushtetuese. Objekti i hetimit, i argumentuar qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme në kërkesë, duhet të përmbajë fakte të përcaktueshme ose kompleks faktesh, të cilat të tregojnë qartë se për çfarë po hetohet. Në këtë mënyrë, objekti i hetimit evidenton dhe çështjen e veçantë. Të gjitha ato çështje që përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që përmbajnë në vetvete një interes publik e përfshijnë këtë kuptim. Dobishmëria e këtyre hetimeve, sigurisht që shihet në nxjerrjen e përgjegjësiwe politike e institucionale, që ndihmon evidentimin e problemeve dhe mospërsëritjen e fenomeneve që kanë ndikim për vetë shoqërinë, por jo çdo çështje publike mund të sqarohet më së miri nga parlamenti dhe të përfshihet në objektin e hetimit.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se dhënia e kuptimit të saktë të shprehjes çështje e veçantë nuk mund të realizohet në mënyrë të plotë në vendimet abstrakte të interpretimit kushtetues. Gjithësesi, lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrësi shterruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në vartësi të situatave të ndryshme që krijohen. Çështjet e hetimit të trajtuara në aspektin e verifikimit të zbatueshmërisë së legjislacionit, të formulimit të propozimeve ose iniciativave ligjore që kanë për qëllim frenimin dhe parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetit, janë të përfshira në konceptin kushtetues si çështje të veçanta. Megjithatë, mbetet në diskrecionin e ligjvënësit dhe në mënyrë të veçantë të një të katërtës së deputetëve, që sipas rasteve konkrete që do të sjellë praktika, duke u orientuar dhe nga formulimet e dhëna në këtë vendim interpretues, të konkludojnë për qëndrimin përkatës. Jurisprudenca kushtetuese që do trajtojë në mënyrë konkrete kushtetutshmërinë e çështjeve të tilla, sigurisht që mund t’i jap një kuptim më të plotë në të ardhmen kësaj dispozite kushtetuese.

Mbi bazën e kësaj analize doktrinare që Gjykata Kushtetuese i bën nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, nisur dhe nga fakti se përveç kryerjes së funksionit të saj kushtetues për interpretimin përfundimtar të çështjes objekt shqyrtimi, nuk merr përsipër të krijojë norma të reja, ajo arrin në përfundimin se interpretimi i bërë i dispozitave, fjalive ose shprehjeve konkrete brenda saj, ka për qëllim që në mënyrë analitike të japë dhe të përcaktojë konceptet bazë si dhe parimet mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me zbatimin e drejtë dhe korrekt të saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 124 e 134 të Kushtetutës si dhe në nenet 71, 72 dhe 79 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Interpretimin e nenit 77 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë në këtë mënyrë:

1. Komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit, të cilat ngrihen për çështje të veçanta, të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësi;

2. Ngritja e komisioneve hetimore parlamentare, kur kërkohet nga një e katërta e deputetëve, është e detyrueshme. Objekti dhe fusha e veprimit të komisioneve hetimore, duhet të respektojë parimet kushtetuese dhe normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, duke mos cenuar pavarësinë dhe duke mos penguar veprimtarinë e organeve të pushteteve të tjera.

3. Parimet kushtetuese, veçanërisht, parimi i ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, i prezumimit të pafajësisë, i paanshmërisë, i respektimit të jetës private të individit, përbëjnë standarde kushtetuese mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë komisionet hetimore parlamentare.

4. Çështjet e veçanta që përbëjnë thelbin e objektit të veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, të cilat e përmbajnë në vetvete interesin publik, janë ato që hetohen në aspektin e kontrollit e të zbatimit të ligjeve, të njohjes e verifikimit në thellësi të një fenomeni, ngjarjeje a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime, amendime ose miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetin dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

RREGULLORE

MBI PROCEDURAT E SHITJES SË MALLRAVE ME ANKAND NË BANKËN E SHQIPËRISË

Neni 1

Baza ligjore dhe qëllimi

1.1 Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 43 gërma (g), si dhe të akteve nënligjore të miratuara në Bankën e Shqipërisë, në fushën e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme.

1.2 Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave të shitjes së mallrave të nxjerra jashtë përdorimit në Bankën e Shqipërisë, me synim realizimin e të ardhurave në favor të Bankës së Shqipërisë.

Neni 2

Përcaktime

Sa herë që përdoren në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Ankand”, nënkupton procedurat e shitjes së mallrave në Bankën e Shqipërisë, sipas kësaj rregulloreje.

“Mallra të Bankës së Shqipërisë”, kuptohen ato mallra (sende të luajtshme) që me miratim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe janë destinuar për t'u shitur me procedurë ankandi.

“Konkurrues”, kuptohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj të cilët i përgjigjen njoftimit të bërë nga Banka e Shqipërisë për të marrë pjesë në ankand.

“Komisioni”, kuptohet “Komisioni i shitjes me ankand” i krijuar në bazë të kësaj rregulloreje.

Neni 3

Rastet e përdorimit të procedurës së ankandit

Do të përdoret procedurë ankandi për të gjitha mallrat të cilat me vendim të Këshillit Mbikëqyrës janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe janë destinuar për t'u shitur me ankand.

Neni 4

Departamenti përgjegjës

Për efekt të kësaj rregulloreje, Departamenti i Administrimit në Bankën e Shqipërisë, ngarkohet:

- të përgatisë dokumentacionin përkatës për fillimin e procedurës së ankandit;
- të bashkëpunojë me komisionin e shitjes me ankand;
- të ekzekutojë vendimet e komisionit të shitjes me ankand.

Neni 5

Komisioni i shitjes me ankand

5.1 Për realizimin e procedurës së shitjes së mallrave me ankand ngrihet komisioni, i cili miratohet me shkrim nga Drejtori i Departamentit të Administrimit. Ky komision përbëhet nga tre persona: kryetari i komisionit (që si i tillë është kryetari i komisionit të prokurimit), përgjegjësi i sektorit të financës, si dhe një specialist i caktuar sipas objektivit përkatës të shitjes me ankand.

5.2 Komisioni ka këto të drejta dhe detyrime:

- përcakton dhe vendos mbi dokumentet e ankandit, që do t'u shpërndahen konkurruesve, mbi çmimin e shpërndarjes së tyre, mbi kriteret e vlerësimit paraparak që lidhen me plotësimin e dokumentacionit dhe mbi respektimin e kushteve të parashikuara në dokumentacionin e ankandit dhe vlerësimin ekonomik të ofertave të konkurruesve;
- merr pjesë dhe ka autoritet në hapjen, në shqyrtimin dhe në vlerësimin e ofertave të dorëzuara nga konkurruesit;
- gjykon mbi korrektësinë e të gjithë dokumentacionit të sjellë nga konkurruesi;
- paraqet pranë Drejtorit të Departamentit të Administrimit një relacion përmbledhës për procedurën e përfunduar, si dhe argumentimin për përzgjedhjen e ofertës (konkurruesit) fituese, të firmosur nga anëtarët e tij (në formën e një vendimi).

Çdo anëtar ka të drejtën e një vote. Në rast barazimi (kur një anëtar abstenon) vota e kryetarit është përcaktuese. Në rast se mungon qoftë dhe një nga anëtarët e komisionit, mbledhja shtyhet për një kohë të dytë, të përcaktuar nga komisioni dhe të miratuar nga Drejtori i Departamentit të Administrimit.

5.3 Komisioni asistohet në punën e tij nga sektori i prokurimit të Bankës së Shqipërisë.

Sektori i prokurimit, për efekt të kësaj rregulloreje, ka këto detyra:

- asiston përgatitjen e dokumentacionit për ankand;
- bën shpalljen e njoftimit për ankand;
- sqaron konkurruesit për çdo paqartësi që mund të kenë gjatë hartimit të ofertave në lidhje me dokumentacionin e ankandit të marrë nga Banka e Shqipërisë;
- mban të gjitha praktikat dokumentare në lidhje me zhvillimin e ankandit, përfshirë librin e procesverbaleve të punës së komisionit dhe kërkon firmosjen e tyre nga anëtarët e komisionit. E gjithë dosja me dokumente origjinale, pas përfundimit të një procedure ankandi, depozitohet në arkivin e Bankës së Shqipërisë. Po kështu, në çdo fund viti, depozitohet edhe libri i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, për vitin përkatës.

Neni 6

Format e komunikimit

Komunikimi ndërmjet konkurruesve dhe komisionit bëhet me shkrim. Komisioni mund të vendosë që të realizojë takime për sqarimin e konkurruesve lidhur me formulimin e ofertave ose për prezantimin fizik të objektit të shitjes. Përmbajtja e këtyre takimeve duhet të pasqyrohet në librin e procesverbaleve.

Njoftimi për zhvillimin e ankandit nga Banka e Shqipërisë realizohet nëpërmjet afishimit të lajmërimit në ambientet e përcaktuara në Bankën e Shqipërisë, në e-mail, në website-n e Bankës së

Shqipërisë dhe nëpërmjet publikimit të këtij njoftimi në të paktën dy gazeta me tirazh më të madh, në tre numra të njëpasnjëshëm të tyre, dhe/ose nëpërmjet medias elektronike.

Neni 7

Procedura e zhvillimit të ankandit

Kjo procedurë fillon pas lëshimit të urdhrit (të protokolluar) nga Drejtori i Departamentit të Administrimit për zhvillimin e ankandit ku shënohen, anëtarët e komisionit, objekti i shitjes me ankand, sasia dhe çmimi minimal i shitjes (në rast se parashikohet një i tillë).

Komisioni përgatit njoftimin dhe e shpall atë, siç parashikohet në këtë rregullore.

Njoftimi përmban adresën e shitësit (Bankës së Shqipërisë), objektin e shitjes, ku dhe si do të sigurohet dokumentacioni lidhur me ankandin, afatin e fundit të paraqitjes së ofertës, vendin, datën dhe orën e hapjes së zarfeve të ofertave, si dhe pjesëmarrjen në hapjen e tyre.

Konkurruesve u mundësohet njohja vetë fizikisht me mallin objekt i shitjes me ankand.

Komisioni përgatit dokumentacionin e ankandit në përputhje me anekset, pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Afati i fundit i pranimi të ofertave nuk duhet të jetë më pak se 15 ditë pune nga data e fundit e publikimit të njoftimit. Afati vendoset nga komisioni për çdo rast konkret.

Oferta duhet të paraqitet me një zarf, i cili duhet të jetë i mbyllur. Në anën e përparme të tij duhet të shkruhet adresa: Banka e Shqipërisë, Komisioni i Shitjes me Ankand dhe brenda tij të ketë formularin e ofertës së ankandit, sigurimin e ofertës, si dhe ndonjë dokument tjetër të kërkuar sipas rastit në dokumentacionin e ankandit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të nënshkruara nga konkurruesit (për firmat konkurruese të nënshkruara dhe të vulosura nga titullari përkatës). Nëse nuk plotësohen kërkesat e mësipërme, oferta nuk merret në konsideratë. Konkurruesi ka të drejtë të kërkojë sqarime me shkrim për formën dhe për përmbajtjen e ofertës që do të paraqesë, si dhe të dokumenteve të tjera që i kërkojnë, deri në 5 ditë pune para afatit të fundit të pranimi të ofertave dhe komisioni është i detyruar t'i kthejë përgjigje brenda 3 ditëve pune nga marrja e kërkesës.

Ofertat (zarfet) që mbërrijnë më vonë se afati i caktuar, regjistrohen dhe u kthehen menjëherë e të pahapura konkurruesve.

Ankandi (hapja e zarfeve nga komisioni) hapet në ditën, në orën dhe në vendin e caktuar.

Në seancën e hapjes së zarfeve, përveç komisionit, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të konkurruesve.

Shqyrtimi i ofertave bëhet në dy faza:

a) Faza e parë është shqyrtimi paraprak dhe ka të bëjë me shqyrtimin në vend, në prani të konkurruesve të dokumenteve, të formës së paraqitjes së tyre etj. Kur këto nuk janë në përputhje me rregullat dhe me kriteret e përcaktuara në ftesën e ankandit, oferta përjashtohet nga konkurrimi i mëtejshëm. Konkurruesve të kualifikuar si më sipër u lexohet me zë të lartë oferta.

b) Faza e dytë është ajo e shqyrtimit ekonomik ku analizohen çmimet, sasitë, verifikohen vlefat etj., në përputhje me kriteret e vlerësimit ekonomik. Përparësi në vlerësim do të kenë ofertat duke filluar me çmime më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin minimal të shitjes.

Komisioni, në bazë të kriterëve të përcaktuara, brenda dy ditëve pune nga data e hapjes së ankandit, klasifikon ofertat dhe vendos për ofertën me leverdisshmëri më të madhe ekonomike. Ky vendim nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Nëse gjatë vlerësimit rezulton se disa konkurrues kanë ofruar çmim dhe sasi të njëjtë me atë të një oferte fituese, me short do të vendoset fituesi i ofertës më të mirë. Shorti do të organizohet në prani të konkurruesve ose të përfaqësuesve të autorizuar të tyre, duke vendosur emrat e konkurruesve në një kuti dhe komisioni pas tërheqjes së tyre, bën klasifikimin e konkurruesve.

Neni 8

Shpallja dhe njoftimi i fituesit, nënshkrimi eventual i kontratës

Kryetari i komisionit, dërgon vendimin për mendim e miratim tek Drejtori i Departamentit të Administrimit. Pas këtij momenti, Drejtori i Departamentit të Administrimit shpall ofertën fituese brenda 2 ditëve pune nga marrja e vendimit të komisionit dhe njofton konkurruesin fitues për lidhjen e kontratës me shkrim ose për pagimin e çmimit të shitjes kundrejt faturës (pa kontratë me shkrim).

brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës. Në rast se konkurruesi që ka fituar nuk pranon dhe tërhiqet, kjo dokumentohet dhe shpallet fituese oferta pasardhëse në klasifikim.

Në rast se Drejtori i Departamentit të Administrimit gjykon se me fituesin do të lidhet kontratë me shkrim, kjo kontratë nënshkruhet nga vetë ai.

Neni 9 **Sigurimi i ofertës**

Në dokumentet e ankandit, sipas gjykimit të komisionit, mund të përfshihet një kusht, sipas të cilit, ofertat duhet të shoqërohen me një sigurim në formën e një garancie bankare ose të një garancie të dhënë nga shoqëritë e sigurimit, sipas formularit të sigurimit të ofertës, pjesë e dokumenteve të ankandit. Kjo shumë, e shprehur në vlerë absolute, nuk duhet të jetë më e madhe se 1/2 e çmimit minimal të shitjes, të përcaktuar në dokumentet e ankandit.

Sigurimi i ofertës është i detyrueshëm në rastin kur vlera minimale e çmimit minimal të shitjes është mbi 20 000 lekë. Në rastin kur nuk është përcaktuar çmim minimal shitjeje, nuk do të kërkohej sigurim oferte.

Sigurimi i ofertës konfiskohet nga Banka e Shqipërisë, në rast se një konkurrues tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertës ose në rastin e një konkurruesi fitues, i cili heq dorë nga lidhja e kontratës ose nga pagimi i çmimit të shitjes. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të konfiskojë sigurimin e ofertës, nëse në rast gabimi aritmetik, një pjesëmarrës nuk pranon të korrigjojë ofertën e tij.

Sigurimi i ofertës për konkurruesit çlirohet pas shpalljes së fituesit, ndërsa sigurimi i ofertës për fituesin çlirohet pas pagimit të çmimit të shitjes.

Punonjësit e Bankës së Shqipërisë, në rastet kur kërkohej paraqitja e sigurimit të ofertës, mund të paraqesin të nënshkruar një deklaratë personale, sipas formularit përkatës pjesë e dokumenteve të ankandit.

Neni 10 **Anulimi i procedurës së ankandit dhe përsëritja e tij**

Ankandi përsëritet kur:

- a) asnjë ofertë nuk kënaq kushtet ekonomike të ofruara (të gjitha ofertat janë nën çmimin minimal të kërkuar të shitjes);
- b) të gjitha ofertat përmbajnë parregullsi thelbësore që e pengojnë shqyrtimin normal të tyre;
- c) të gjitha ofertat skualifikohen në fazën e parë;
- d) në afatin e caktuar nuk paraqitet asnjë ofertë.

Në rastin e parashikuar në pikën (a) të këtij neni, komisioni vendos për përsëritjen e ankandit duke respektuar afatin 15-ditor. Nëse dhe në afatin e ri komisioni ndodhet përpara të njëjtit rast, atëherë procedura e ankandit anulohet dhe fillon një procedurë e re ankandi, duke ulur me ½ çmimin minimal të kërkuar të shitjes.

Në rastet e parashikuara në pikat (b) ose (c) të këtij neni, komisioni vendos për përsëritjen e ankandit duke respektuar afatin 15-ditor. Nëse edhe në afatin e ri komisioni ndodhet përpara të njëjtit rast, ai i relaton Drejtorit të Departamentit të Administrimit, i cili vendos për hapat e mëtejshëm.

Në rastin e parashikuar në pikën (d) të këtij neni, komisioni vendos për një afat të ri të fundit për pranimin të ofertave deri në jo më pak se 10 ditë pune nga data e fundit e publikimit të këtij njoftimi. Nëse dhe në afatin e ri nuk paraqitet ndonjë ofertë, komisioni i relaton Drejtorit të Departamentit të Administrimit, i cili vendos për hapat e mëtejshëm.

Neni 11 **Të fundit**

Anekset bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.33, datë 23.4.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të saj në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Shkëlqim Cani

ANEKSI NR.1

DOKUMENTET STANDARDE PËR PROCEDURAT E ANKANDEVE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja :

Ftesa për ankand.
Kriteret dhe kushtet e përgjithshme për konkurruesit në ankand.
Përshkrimi i objektit konkret të shitjes me ankand.
Formulari i ofertës për ankand:
për konkurruesit individë;
për konkurruesit person fizik / juridik.
Formulari i sigurimit të ofertës:
lëshuar nga bankat;
lëshuar nga shoqëri sigurimi;
deklaratë personale në ankandin e mbyllur.

Komisioni i shitjes me ankand
Tiranë, më ____/____/200__
FTESË PËR ANKAND

Banka e Shqipërisë fton individët, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj për të marrë pjesë në ankand për shitjen e _____ (lloji, sasia e mallit dhe disa të dhëna të përgjithshme mbi mallin në shitje).

Të interesuarit mund të tërheqin dokumentet e ankandit pranë sektorit të prokurimit në Departamentin e Administrimit të Bankës së Shqipërisë, me adresë : “Banka e Shqipërisë (Departamenti i Administrimit), Sheshi SKËNDERBEJ Nr.1 Tiranë”, Tel. 355 42 22230(185), Faks: 355 42 235 58, kundrejt një pagese prej _____ lekë.

Hapja e dokumentacionit do të bëhet në datë _____.____.200__, ora ____ në adresën e mësipërme. Dërgimi i ofertës mund të bëhet duke dërguar zarfin më postë ose edhe me paraqitjen e vetë konkurruesve apo të përfaqësuesve të tyre të autorizuar në adresën e mësipërme.

Mënyra e dorëzimit të dokumenteve dhe e vlerësimit të tyre do të bëhet sipas përcaktimeve të bëra në kriteret dhe në kushtet e përgjithshme për konkurruesit në ankand, pjesë e këtyre dokumenteve ankandi.

Për Bankën e Shqipërisë

Kryetari i komisionit të shitjes me ankand

KRITERET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR KONKURRUESIT NË ANKAND

Banka e Shqipërisë ju fton për të konkurruar në ankandin për shitjen _____ (lloji, sasia e mallit) sipas përcaktimit në ftesën për ankand dhe në përshkrimin e objektit konkret të shitjes me ankand, pjesë përbërëse e këtyre dokumenteve të ankandit)

1. Pronësia e mallit :Në pronësi të Bankës së Shqipërisë.
2. Gjuha e ofertës dhe çmimi i shitjes : Gjuha e ofertës do të jetë gjuha shqipe dhe çmimi i shitjes së mallit nga konkurruesi duhet të jepet në lekë¹.

3. Çmimi minimal i shitjes së mallit: Çmimi minimal i shitjes së mallit është _____ lek.²
4. Shpjegimi i dokumenteve dhe njohja fizike e mallit objekt i shitjes: Çdo konkurrues ka të drejtë të kërkojë sqarime me shkrim për formën dhe për përmbajtjen e ofertës që do të paraqesë, si dhe të dokumenteve të tjera që i kërkojnë, deri në 5 ditë pune para afatit të fundit të pranimit të ofertave dhe komisioni është i detyruar t'i kthejë përgjigje brenda 3 ditëve pune nga marrja e kërkesës.

Konkurruesve u jepet mundësia që më datë _____.200__, nga ora _____ deri në orën _____ të shohin vetë fizikisht mallin objekt i shitjes me ankand.

5. Shtesa dhe ndryshime në dokumentet e ankandit: Banka e Shqipërisë mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit përpara datës së caktuar për hapjen e tij. Këto ndryshime u njoftohen me shkrim të gjithë konkurruesve. Në rast se gjykohet e arsyeshme, komisioni mund të shtyjë afatin e hapjes së ankandit brenda një kohe që ky Komision e gjykon të mjaftueshme për përgatitjen e saktë të ofertave.

6. Vlefshmëria e ofertës: është minimumi _____ ditë.

7. Sigurimi i ofertës³: Çdo konkurrues duhet të paraqesë sigurimin e ofertës në shumën prej _____. Mosparaqitja e dokumentit të sigurimit të ofertës apo paraqitja jo sipas përcaktimit të bërë në formularin e sigurimit të ofertës, pjesë e këtyre dokumenteve të ankandit përbën kusht skualifikues. Sigurimi i ofertës konfiskohet nga Banka e Shqipërisë, në rast se një konkurrues tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertës ose në rastin e një konkurruesi fitues, i cili heq dorë nga lidhja e kontratës ose nga pagimi i çmimit të shitjes. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të konfiskojë sigurimin e ofertës, nëse në rast gabimi aritmetik, një pjesëmarrës nuk pranon të korrigjojë ofertën e tij.

Sigurimi i ofertës për konkurruesit çlirohet pas shpalljes së fituesit, ndërsa sigurimi i ofertës për fituesin çlirohet pas pagimit të çmimit të shitjes.

8. Procedura e hapjes së ankandit dhe e vlerësimit të ofertave : Ankandi (hapja e zarfeve nga komisioni) hapet në ditën, në orën dhe në vendin e caktuar. Ofertat (zarfet) që mbërrijnë më vonë se afati i caktuar, regjistrohen dhe u kthehen menjëherë e të pahapura konkurruesve.

Konkurruesi në ankand, mund të paraqesë vetëm një ofertë sipas objektit të shitjes dhe përcaktimeve në dokumentet e ankandit. Oferta duhet të paraqitet me një zarf, i cili duhet të jetë i mbyllur. Në anën e përparme të tij duhet të shkruhet adresa: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Administrimit, Komisioni i Shitjes me Ankand dhe brenda tij të ketë formularin e ofertës së ankandit si dhe dokumentet e kërkuara për fazën e vlerësimit paraprak, në dokumentacionin e ankandit. Formulari i ofertës për ankand, pjesë e dokumenteve të ankandit, duhet të jetë i nënshkruar nga konkurruesit (për firmat konkurruese, të nënshkruara dhe të vulosura nga titullari përkatës). Nëse nuk plotësohen kriteret dhe kërkesat e mësipërme, oferta skualifikohet dhe nuk merret në konsideratë.

Në seancën e hapjes së zarfeve, përveç komisionit, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të konkurruesve.

Shqyrtimi i ofertave bëhet në dy faza:

Faza e parë është shqyrtimi paraprak dhe ka të bëjë me shqyrtimin në vend, në prani të konkurruesve të dokumenteve, të formës së paraqitjes së tyre etj. Kur këto nuk janë në përputhje me rregullat dhe me kriteret e përcaktuara në këto dokumente ankandi, oferta përjashtohet nga konkurrimi

¹ Për rastet e konkurruesve të huaj ky çmim mund të jepet në një monedhë tjetër (dollarë ose euro) e konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për ditën e zhvillimit të ankandit. Gjuha do të jetë gjuha angleze.

² Në rast se është përcaktuar një çmim i tillë në urdhrin përkatës për zhvillimin e ankandit.

³ Për rastin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë i bëhet referim deklaratës që duhet të paraqitet nga punonjësi.

i mëtejshëm.

Faza e dytë është ajo e shqyrtimit ekonomik ku analizohen çmimet, sasitë, verifikohen vlefstat etj., në përputhje me kriteret e vlerësimit ekonomik. Përparësi në vlerësim do të kenë ofertat duke filluar me çmime më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin minimal të shitjes. Të gjithë konkurruesve të kualifikuar në fazën e parë, u lexohet dhe deklarohet emri dhe vlera e çdo oferte të dhënë.

Procesverbali i seancës të hapjes së zarfeve hartohet nga komisioni dhe një kopje e tij mund t'u vihet në dispozicion pjesëmarrësve në ankand.

Nuk do të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, me përjashtim të korrigjimit të gabimeve aritmetike, për të cilat njoftohen menjëherë konkurruesit.

Banka e Shqipërisë me pranimin e konkurruesit, do të korrigjojë shumën totale të ofertës, e cila do të jetë e detyrueshme për ofertuesin. Mospranimi i korrigjimit është kusht skualifikues. Nëse gjatë vlerësimit rezulton se disa konkurrues kanë ofruar çmim dhe sasi të njëjtë me atë të një oferte fituese, me short do të vendoset fituesi i ofertës më të mirë. Shorti do të organizohet në prani të konkurruesve ose të përfaqësuesve të autorizuar të tyre, duke vendosur emrat e konkurruesve në një kuti dhe komisioni, pas tërheqjes së tyre, bën klasifikimin e konkurruesve.

Fituesi i ankandit do të njoftohet me shkrim, brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës, të lidhë kontratën ose të paguajë çmimin e shitjes. Në rast se fituesi refuzon ose nuk paraqitet brenda afatit të caktuar për lidhjen e kontratës, ose nuk paguan çmimin e shitjes, kjo dokumentohet dhe ai do të zëvendësohet me konkurruesin, oferta e të cilit është klasifikuar në renditje pas tij.

9. Dokumentet që konkurruesit në ankand duhet të paraqesin për fazën e vlerësimit paraprak.¹

Formulari i sigurimit të ofertës për ankand (origjinal).

Vendimi i gjykatës për fitimin e personalitetit juridik (për personat fizikë ose juridikë) (kopje e notëruar).

Certifikata e regjistrimit në organin tatimor (për personat fizikë ose juridikë) (kopje e notëruar).

Dokumentin identifikues për konkurruesit individë (letërnjoftim/pasaportë/dëshmi aftësie për drejtimin e automjetit (kopje e notëruar e tyre) ose certifikatë origjinale me fotografi).

Mosparaqitja e ndonjërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.

10. Kriteri i vlerësimit ekonomik²

Do të shpallet fituese oferta që ka çmimin më të lartë dhe që vlera e së cilës është më e madhe ose e barabartë me çmimin minimal të shitjes. Ofertat me çmim (vlerë) më të vogël se çmimi minimal i shitjes skualifikohen.

11. Mënyra e pagesës: Pagesa për mallin e shitur do të bëhet në lekë³

FORMULARI I OFERTËS PËR ANKAND (PËR KONKURRUESIT INDIVIDË)⁴

_____, më _____.200__

Unë _____ banues në _____
(emër, mbiemër)(adresa e plotë)

pasi u njoha me dokumentet e ankandit që organizohet nga Banka e Shqipërisë për shitjen e (lloji i mallit), duke pranuar plotësisht kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e këtij

¹ Për rastet kur konkurrojnë edhe punonjës të Bankës së Shqipërisë kërkohet vetëm sigurimi i ofertës (deklarata) ndërsa dokumentet e tjera nuk kërkohen.

² Sipas rastit konkret të objektit të ankandit, komisioni mund të vendosë që të vlerësojë ofertën të ndarë sipas artikujve të nxjerrë për shitje.

³ Mënyra, kushtet e pagesës, afatet dhe penalitetet për vonesën e pagesës vendosen sipas gjykimit të komisionit dhe sipas objektit konkret të shitjes.

⁴ Për rastet kur konkurrojnë dhe punonjës të Bankës së Shqipërisë, shtohet përcaktimi "punonjës i Bankës së Shqipërisë".

ankandi, ju paraqes ofertën time si më poshtë vijon:

Çmimi _____ për secilin mall (artikull)

(në numër dhe fjalë)

për sasinë e mallit (artikujve) _____

(në numër e fjalë)

dhe vlefshëm totale _____

(në numër e fjalë).

Vlefshmëria e kësaj oferte është _____ ditë.

(në numër e fjalë)

KONKURRUESI

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

FORMULARI I OFERTËS PËR ANKAND
(PËR KONKURRUESIT PERSON FIZIK OSE JURIDIK)

_____, më ____ . ____ .200__

_____ me seli në _____
(emërtimi i personit fizik ose juridik)(adresa e plotë)
pasi u njoh me dokumentet e ankandit që organizohet nga Banka e Shqipërisë për shitjen e
(lloji i mallit), duke pranuar plotësisht kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e këtij
ankandi, ju paraqet ofertën e saj si më poshtë vijon:

Çmimi _____ për secilin mall (artikull)
(në numër dhe fjalë)

për sasinë e mallit (artikujve) _____
(në numër e fjalë)

dhe vleftën totale _____
(në numër e fjalë)

Vlefshmëria e kësaj oferte është _____ ditë.
(në numër e fjalë)

KONKURRUESI

(emërtimi i personit fizik ose juridik,
emri, mbiemri i titullarit, nënshkrimi, vula)

CERTIFIKATË GARANCIE PËR SIGURIM OFERTE
(LËSHUAR NGA SHOQËRI SIGURIMI)

Nr.ref _____ Data _____

Kjo certifikatë dëshmon se shoqëria e sigurimeve _____, me adresë _____ është garantuese e _____ në shumën prej _____ lekësh
(emri i konkurruesit) (në numër dhe fjalë)
si kusht për sigurimin e ofertës së paraqitur në ankandin për shitjen e _____ organizuar nga Banka e Shqipërisë.

(lloji dhe sasia e mallit)
Shoqëria e sigurimeve _____ merr përsipër të kalojë në llogarinë e Bankës së Shqipërisë shumën e mësipërme në rast se :

1. konkurruesi në ankand tërheq ofertën pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;
2. konkurruesi në ankand heq dorë nga lidhja e kontratës ose nga pagimi i çmimit të shitjes nëse shpallet fitues;

me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim nga ana e Bankës së Shqipërisë, pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i njërit prej kushteve të mësipërme.

Kjo garanci është e vlefshme deri në datën që përfshin 30 ditë nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së ofertës.

Për shoqërinë e sigurimeve _____,

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS
(LËSHUAR NGA BANKAT)

Nr.ref _____ Data _____

Me këtë dokument vërtetojmë se _____, ka derdhur
(emri i konkurruesit)
pranë Bankës _____, shumën prej _____
(në numër dhe fjalë)
lekësh si kusht për sigurimin e ofertës së paraqitur në ankandin për shitjen e
_____.
(lloji dhe sasia e mallit)

Banka merr përsipër të kalojë në llogarinë e Bankës së Shqipërisë këtë garanci bankare në rast se:

- konkurruesi në ankand tërheq ofertën pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;
konkurruesi në ankand heq dorë nga lidhja e kontratës ose pagimi i çmimit të shitjes nëse shpallet fitues;
 - me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim nga ana e Bankës së Shqipërisë, pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i njërit prej kushteve të mësipërme.
- Kjo garanci është e vlefshme deri në datën që përfshin 30 ditë nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së ofertës.

Banka _____

Formulari isigurimit të ofertës
(Deklaratë personale)

Unë _____ punonjës i bankës së Shqipërisë, në _____
(emër, mbiemër)

pasi u njoha me dokumentet e ankandit që organizohet nga Banka e Shqipërisë për shitjen e _____

(lloji i mallit),
duke njohur dhe pranuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e këtij ankandi, në bazë të vullnetit tim të lirë e të plotë deklaroj se jam dakord dhe pranoj që në rast se unë:
1. tërheq ofertën pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;
2. heq dorë nga lidhja e kontratës ose pagimi i çmimit të shitjes nëse shpallen fitues,
të më mbahet nga rroga ime mujore shuma përkatëse të sigurimit të ofertës prej _____
lekë.

Deklaruesi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 22.5.2003

Doli nga shtypi më 22.5.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë